

VENDIM
Nr. 45, datë 7.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “KISI-BIO-ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5 pika 1 germa “g”; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1- Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 3 -Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.
- Neni 9, pika 4/10, germa “a” - Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar, i paplotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa “b”-Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit i paplotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, germa “c”- Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., nuk ka realizuar kontrata të mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energji ” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti